



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 355 Prot.

Tiranë, më 13.032019

VENDIM Nr. 41, datë 06.03.2019

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"*, Neni 134, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 2, datë 06.03.2019, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të *projektit "Ndërtim rrjeti inxhinjrik telefonik me Fibra optike dhe Coax" Bashkia Sarandë* -subjekti "ATC CABLE" sh.p.k., realizuar nga individ i licencuar në arkeologji Z. Eduard Shehi,

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të *projektit "Ndërtim rrjeti inxhinjrik telefonik me Fibra optike dhe Coax" Bashkia Sarandë* -subjekti "ATC CABLE" sh.p.k., realizuar nga individ i licencuar në arkeologji Z. Eduard Shehi.
2. Subjekti "ATC CABLE" sh.p.k duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje katër palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji dhe DRKK Vlorë, të cilët duhet të ndjekin në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për projektin "Ndërtim rrjeti inxhinjrik telefonik me Fibra optike dhe Coax" Bashkia Sarandë, si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë ato.
3. Pas lidhjes së akt-marrëveshjes së sipërpërmendur, të vijojë procedura e shqyrtimit dhe vendimmarrjes në organet përkatëse të qeverisjes vendore dhe pas paisjes me lejen përkatëse, të fillojnë punimet e gërmimit, të cilat do realizohen sipas akt-marrëveshje katër palëshe të cituar në pikën 2 të këtij vendimi.
4. Në rrugën "Onhezmi" në pozicionet e pusetave, subjekti i licencuar në arkeologji të kryejë dokumentimin stratigrafik të shtresave, i cili duhet të depozitohet pranë ASHA.
5. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10.2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
7. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

**KRYETAR
ELVA MARGARITI
MINISTËR**



**SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO**